

## *In Memoriam Prof. Dr. Velesin Peçuli*

Kete artikull ja dedikoj profesorit te nderuar, shkencetarit te mirenjohur ne fushen e Ekologjise, Mjedisit e Bujqesise, brenda e jashte vendit, Prof. Dr. Velesin Peçuli. lindur në Dukat, ne 1949. Shkollimin 7 vjeçar e kreu ne Orikum (1956 – 1963) dhe shkollimin e mesëm në Vlorë (1963- 1967). Shkollimin universitar e kreu në fushën e Agronomisë, në Institutin e Lartë Shtetëror të Bujqësisë (sot Universiteti Bujqësor i Tiranës) ne vitet 1967 – 1972 me rezultate te shkelqyera. Pas mbarimit te studimeve, ne vitet 1972 - 1977, punoi si K/agronom në ish-Kooperativën Bujqësore të Qeparoit, të rrethit të Vlorës, ku u dallua per idete e reja qe perçoi e aftesite e larta organizuese, pasqyruar ne rezultatet e larta ne prodhim. Bazuar ne rezultatet e shkolles, potencialin intelektual, njohurite e fituara e aftesite profesionale qe zoteronte, ne vitin 1977 u emerua pedagog ne Institutin e Larte Bujqesor dhe në periudhën 1980-1983, kreu studimet pasuniversitare, në fushën e Agroekologjisë, në Universitetin e Perugia-s (Itali). Pas kthimit nga specializimi vazhdoi punen deri ne fund te jetes se tij si pedagog i Ekologjise e Agroekologjise ne Universitetin Bujqesor, aktualisht ne departamentin e Agromjedisit e Ekologjise. Në vitin 1986, fitoi graden shkencore "*Kandidat i Shkencave*", në vitin 1990, mori titullin "*Docent*" dhe, në vitin 1995, fitoi titullin "*Profesor*". Ne karrierën e tij akademike - shkencore, ka botuar mbi 20 libra (tekste universitare, pasuniversitare, monografi e broshura) dhe mbi 60 artikuj shkencorë (të botuara, brenda e jashte vëndit). Ishte nje njeri i penes e i librave. Ai ishte nje njohes shume i mire i gjuheve te huaja, italiane, franceze dhe angleze. Pervec kontributit te paçmuar ne fushen akademike, ka ushtruar në universitet edhe disa funksione administrative, si përgjegjes katedre, departamenti, Zv/Dekan, Zv/Rektor dhe Rektor (2000 -2007). Nisur nga kontributi i madh i tij ne fushen e kerkimit e te shkences ka marre disa vleresime ndërkombëtare: nga viti 2000 është "*Qytetar Nderi*" i Davis (Kaliforni), nga viti 2001 është mbajtës i "*Urdhërit Naim Frashëri i Artë*", dhënë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Në Nëntor 2011, është shpallur "*Qytetar Nderi*" i qytetit të Orikumit, në qarkun e Vlorës.

Profesor Velesini ishte nje intelektual i madh, nje shkencetar i njohur, nje akademik vizionar e reformator, me ide perendimore, qe i dha arsimit te larte shqiptar ne veçanti, shkencave mjedisore e bujqesise shqiptare nje kontribut te jashtezakonshem.

Ne fushen akademike eshte i padiskutueshem kontributi i tij ne reformimim e arsimit te larte shqiptar, sidomos ne implementimin e procesit te Bolonjes, ku ai ka qene nga inisiatorët e pare; ne reformimin e kurrikulave, ne modernizimin e mesimdhënies e infrastruktures universitare. Ishte perçues i ideve te reja e futjen e nje filozofie te re perendimore ne shkollen e larte, demokratizimin e saj e depolitizimin, rritjen e autonomise universitare. Ishte nje inisiator per lidhjen e vendosjen e urave te bashkepunimit te universitetit me nje sere institucionesh arsimore e kerkimore perendimore prestigjoze.

Ai ishte i pari ekolog ne Shqiperi, me nje formim, botekuptim e filozofi perendimore, me nje pergatitje te larte profesionale, me nje kontribut te spikatur ne futjen e konsolidimin e shkencave ekologjike e mjedisore ne Shqiperi. Ka bashkepunuar me nje sere institucionesh kombetare e nderkombetare per realizimin e shume projekteve kerkimore shkencore ne mbeshtetje te arsimit te larte, te mjedisit e bujqesise ne vend.

Duke qene per tete vite Rektor i Universitetit Bujqesor, ishte nje administrator i shkelqyer, i cili çdo dite mendonte per universitetin dhe nje pjese e konsiderueshme e permiresimeve infrastrukture e dedikohen drejtpersedrejti kontributit personal te tij ne terheqjen e donacioneve nga donatore kryesisht te huaj. Ai universitetin e kishte shtepine e dyte te tij, e konsideronte si te tille dhe ndjehej mire kur ishte ne universitet.

Profesor Velesini ishte ishte nje profesor i dashur per te gjithë. Me nje vizion perendimor, ai dinte te vendoste raporte komunikimi me studentet, te respektonte koleget e te interesohej ne menyre te veçante per punonjesit. Ai dinte te vleresonte njerzit. Ai me qendrimin e tij, ishte nje ze autoritar i padiskutueshem brenda e

jashte Universitetit. Ishte nje njeri zemergjere qe donte ti ndihmonte te gjithë, veçanerisht mbeshteste te rinjte, nje burre i mençur e trim, nje baba e bashkeshort shembullor, nje shok e mik i rralle, nje njeri model, nje altruist i jashtezakonshem.

Per fat te keq, profesori u nda para kohe nga jeta, koleget, shoket e miqte humben njeriun e dashur, familja humbi njeriun e shtrenjte, une personalisht humba profesorin tim qe me orientoi ne rrugen e jetes, shokun, mikun, kolegun 30 vjeçar te zyres, bashkepuntorin e dashamiresin me te mire qe kam njohur ne jeten time e qe do ti jem mirenjohes perjete.

Nepermjet ketij artikulli deshiroj te kujtojme gjithmone profesorin, mikun, shokun, kolegun e pedagogun e nderuar Prof. Dr. Velesin Peçuli.

I paharruar qofte perjete emri i tij.

Prof. as. Dr. Albert KOPALI